

# *Faktorët e rrezikut dhe viktimizimi i nxënësve të shkollave të mesme*

Aliriza Arënlju<sup>1</sup>

Mytaher Haskuka<sup>2</sup>

Kaltrina Kelmendi<sup>3</sup>

Njomza Llullaku<sup>4</sup>

## **Abstrakti**

Hyrje: Qëllimi i këtij artikulli është të kuptuarit e faktorëve të rrezikut që lidhen me dhunën e vetë-raportuar proaktive dhe viktimizimin në mesin e nxënësve kosovarë të shkollave të mesme.

Metodat: Të dhënat janë marrë nga 4709 nxënës të shkollave të mesme të moshës 15 – 16 vjeçare nga Kosova, që kanë marrë pjesë në Projektin Evropian për studimin në shkolla mbi alkoolin dhe drogat e tjera (ESPAD). Ky studim ka ndjekur metodologjinë e standardizuar, përcaktimin e mostrës, administrimin dhe kërkesat etike të njëjta me anketën (studimin) e PESHAD (ESPAD), gjë që siguron krahasueshmëri me vendet evropiane.

Rezultatet: Rezultatet nga ky studim mbështesin të gjeturat nga studimet e tjera<sup>5</sup>se meshkujt kanë pasur mesatare më të lartë si në dhunën proaktive ashtu edhe në viktimizim, në krahasim me femrat dhe dallimi është signifikant ( $p < 0.001$ ). Pos kësaj, analiza e regresionit logjistik binar ka treguar se faktorët që përputhen (të ngjashëm) duket të kenë lidhje me ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimit në

---

<sup>1</sup> Prof. Ass. Dr. Aliriza Arënlju, Universiteti i Prishtinës, Departamenti i psikologjisë, aliriza@filozofik.uni-pr.edu

<sup>2</sup> Prof. Ass. Dr. Mytaher Haskuka, Universiteti i Prishtinës, Departamenti i psikologjisë, mytaher.haskuka@uni-pr.edu

<sup>3</sup> Kaltrina Kelmendi, kandidate për doktoraturë, Universiteti i Prishtinës, Departamenti i psikologjisë, kaltrina.kelmendi@uni-pr.edu

<sup>4</sup> Njomza Llullaku, kandidate për doktoraturë, AAB, Departamenti i kujdesit për fëmijë dhe mirëqenie, njomza.llullaku@aab-edu.net

<sup>5</sup> Cairns RB, Cairns BD, Neckerman HJ, Ferguson LL, dhe Garipey JL, "Growth and aggression: 1. Childhood to early adolescence," *Developmental Psychology* 25, no.2 (1989):320–330.

mesin e adoleshentëve kosovarë. Ndërlidhja më e ngushtë për dhunën proaktive dhe viktimizimin ishte me konsumimin e alkoolit më shumë se 30 ditë, përcjellë nga ikja nga mësimi dhe disponimi depresiv. Ndërlidhja më e dobët është vërejtur me marrëdhënien me prindërit dhe gjininë. Megjithatë, rezultatet e vetëvlerësimit kanë treguar se nuk ka pasur dallime statistike signifikante në mes dhunës proaktive dhe viktimizimit. Të gjitha të lartpërmendurat tregojnë se dhuna proaktive dhe viktimizimi në mesin e adoleshentëve përkojnë me njëra-tjetrën, duke theksuar rolin e tyre si kryes dhe viktimë.<sup>7</sup>

*Fjalët kyçe: dhuna proaktive, viktimizimi, vetëvlerësimi, depresioni, konsumimi i alkoolit*

## **Hyrje**

Adoleshenca është një periudhë e pjekjes fizike, psikologjike dhe sociale nga fëmijëria në moshë madhore.<sup>8,9</sup>Përgjatë kësaj periudhe, adoleshentët kalojnë nëpër ndryshime të llojllojshme në jetën e tyre, duke përfshirë ndryshime biologjike dhe psikologjike.<sup>10</sup> Të dhënat nga hulumtimet tregojnë se për shkak të këtyre ndryshimeve, adoleshentët janë në rrezik të shfaqin probleme shëndetësore mendore dhe zhvillimore si depresioni, ankthi dhe stresi, probleme me familjen dhe

---

<sup>6</sup> Pellegrini AD, Bartini M, Brooks F, "School bullies, victims, and aggressive victims: Factors relating to group affiliation and victimization in early adolescence," *J Educ Psychol* 91, no.2 (1999):216-224.

<sup>7</sup> Singer S, "Victims of serious violence and their criminal behavior: Subcultural theory and beyond", *Victims Violence* 1, no.1 (1986):61-70.

<sup>8</sup> Cameron JL, "Interrelationships between hormones, behaviors, and affect during adolescence," *Annals of the New York Academy of Sciences*, 1021 (2004): 134-42.

<sup>9</sup> Dahl RE, "Adolescent brain development: A period of vulnerabilities and opportunities," *Annals of New York Academia of Science*, 102 (2004): 1-22.

<sup>10</sup> Graham RA et al., "The existential model of perfectionism and depressive symptoms: a short four wave longitudinal study," *Journal of Consulting Psychology*, 57 (2011): 23-438.

shokët, vetmia apo mospranimi, mendime për vetëvrasjen, sjellje të dhunshme dhe sjellje vetëvrasëse.<sup>11</sup>

Dhuna, viktimizimi dhe ushtrimi i dhunës janë identifikuar si faktorë seriozë të rrezikut për zhvillim të dobët të adoleshentëve.<sup>12</sup> Hulumentimet kanë theksuar rëndësinë e ndarjes në mes të dy lloje sjelljesh të dhunshme: sjellje të dhunshme proaktive dhe reaktive.<sup>13</sup> Dhuna proaktive definohet si instrumentale, fyese dhe “gjakftohtë”, as provokuese as me zemërim, përderisa sjellja e dhunshme reaktive definohet si afektive, defanzive dhe “gjaknxehët”.<sup>14</sup> Të gjeturat<sup>12</sup> tregojnë se rreth 53% e fëmijëve që përfshihen në disa forma të sjelljes së dhunshme përfshihen në forma të dhunës proaktive dhe reaktive, ndërsa vetëm 32% përfshihen në dhunën reaktive por jo edhe në atë proaktive. Megjithatë, këto dy nënloje të dhunës kanë tendencë të shfaqen së bashku, ku shumica e fëmijëve shfaqin shkallë të njëjtë të agresionit reaktiv dhe atij proaktiv.<sup>15</sup> Dhuna proaktive mund të marrë formën e agresionit instrumental, që synon të marrë një objekt apo privilegj, apo ngacmimi (bulizmi) që përdoret për ta trembur apo dominuar një person tjetër.<sup>16</sup> Përveç kësaj, të gjeturat nga studimi i keqtrajtimit

---

<sup>11</sup> World Health Organization, *Mental health: facing the challenges, building solutions: Report from the WHO European Ministerial Conference*, (Copenhagen: Regional Office for Europe, 2005): 83-89

<sup>12</sup> Barnow S, Lucht M, and Freyberger HJ, “Correlates of aggressive and delinquent conduct problems in adolescence,” *Aggressive Behavior* 31, no.1 (2005):24-39.

<sup>13</sup> Dodge KA, “The structure and function of reactive and proactive aggression,” in *The Development and Treatment for Childhood Aggression 1991*, Pepler D and Rubin K (Hillsdale: Erlbaum, 1991), 201-218.

<sup>14</sup> Brengden M, Vitaro F, Tremblay RE and Lavoie F, “Reactive and pro-active aggression: Predictions to physical violence in different contexts and moderating effects of parental monitoring and caregiving behaviors,” *Journal of Abnormal Child Psychology* 29, no.4 (2001): 293-304.

<sup>15</sup> Hubbard JA, Romani LJ, McAuliffe MD and Morrow MT, “Reactive and proactive aggression in childhood and adolescence: Precursors, outcomes, processes, experiences and measurement,” *Journal of Personality* 78, no.1 (2010):96-118.

<sup>16</sup> Price KF and Dodge KA, “Reactive and proactive aggression in childhood: relations to peer status and social context dimensions,” *Journal of Abnormal Child Psychology*, 17(1989): 455-471.

të fëmijës dhe dhuna te të rinjtë tregon se ushtrimi i dhunës dhe viktimizimi janë të lidhura me njëra tjetrën.<sup>17</sup> Adoleshentët e rinj që janë viktimë të abuzimit janë në rrezik më të lartë për t'u bërë abuzivë në moshë madhore<sup>18</sup> dhe ka një ndërlidhje në mes viktimizimit dhe viktimizimit të mëvonshëm.<sup>19</sup> Duke pasur parasysh kompleksitetin e temës, ka faktorë të ndërlidhur në mes faktorëve individualë, familjarë, të grupeve të moshatarëve, shkollorë dhe komunitarë, që lidhen me ushtrimin e dhunës dhe viktimizimin tek adoleshentët<sup>20</sup>. Për shembull, nga faktorët individualë të rrezikut, përdorimi i substancave, agresioni, gjendja psikologjike, qëndrimet tolerante ndaj dhunës, të gjitha kanë pasur lidhshmëri me ushtrimin e dhunës.<sup>21</sup> Faktorët familjarë si: gjendja e keqe socio-ekonomike/ varfëria, marrëdhënia e dobët prind - fëmijë, prindërit antisocialë, disiplina e rreptë dhe jo-konsistente; prindërit abuzivë dhe neglizhenca duket se ndërlidhen me ushtrimin e dhunës. Qëndrimet e dobëta ndaj shkollës, performanca e dobët akademike, lidhjet e dobëta sociale dhe qëndrime antisociale ndaj moshatarëve duket se ndërlidhen me ushtrimin e dhunës tek adoleshentët; si dhe dhuna në komunitet dhe organizatat e lagjes gjithashtu lidhen me ushtrimin e

---

<sup>17</sup> Maas C, Herrenkohl T, and Sousa C, "Review of research on child maltreatment and violence in youth," *Trauma, Violence & Abuse*, 9(2008): 56-67.

<sup>18</sup> Fang X and Corso PS, "Child maltreatment, youth violence and intimate partner violence: Developmental relationship," *American Journal of Preventive Medicine* 33, no.4 (2007): 281-290.

<sup>19</sup> Desai S, Arias I, Thompson MP, and Basile KC, "Childhood victimization and subsequent adult re-victimization assessed in a nationally representative sample of women and men," *Violence and Victims* 17, no.6 (2002): 639-653.

<sup>20</sup> Office of the Surgeon General (US); National Center for Injury Prevention and Control (US); National Institute of Mental Health (US); Center for Mental Health Services (US). Youth Violence: A Report of the Surgeon General. Rockville (MD): Office of the Surgeon General (US); 2001. Chapter 4 -- [http://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK44293/Risk\\_Factors\\_for\\_Youth\\_Violence](http://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK44293/Risk_Factors_for_Youth_Violence).

<sup>21</sup> Saner H and Ellickson P, "Concurrent risk factors for adolescent violence," *Journal of Adolescence Health*, 19(1996): 94-103.

dhunës tek adoleshentët.<sup>22</sup> Më tutje, marrëdhënia në mes dhunës proaktive dhe konstrukteve psikologjike ka treguar të jetë e shumanshme, sidomos sa i përket depresionit dhe vetëvlerësimit. Disa studime sugjerojnë se ka lidhje modeste në mes të depresionit dhe ushtrimit të dhunës, ndërsa studime të tjera raportojnë mungesë të ndërlidhjes signifikante të dhunës dhe depresionit.<sup>23</sup> Kur është analizuar marrëdhënia në mes të vetëvlerësimit dhe ushtrimit të dhunës, rezultatet shfaqin se disa adoleshentë që janë përfshirë në sjellje të dhunshme shfaqin vetëvlerësim më të ulët krahasuar me ata që nuk janë përfshirë në probleme të sjelljes së dhunshme,<sup>24</sup> ndërsa studime të tjera të kryera nga Olweus<sup>25</sup> dhe Rigby & Slee<sup>26</sup> raportojnë se adoleshentët e dhunshëm kanë pikë të larta në këtë konstrukt.<sup>27</sup> Sjelljet e rrezikshme gjithashtu lidhen me mundësitë e ushtrimit të dhunës dhe viktimizimit në adoleshencë, që tregon se abuzimi me substanca dhe përdorimi i alkoolit është rezultat dhe kontribuues i dhunës.<sup>28</sup> Po ashtu, marrëdhënia prind - adoleshent është konsideruar si një faktor i rëndësishëm në sjelljet e mëvonshme delikuede dhe mund të shërbejë si ndërmjetësues për uljen e nivelit të

---

<sup>22</sup> Dawkins MP, "Drug use and violent crime among adolescents," *Adolescence*, 33(1997): 395-405.

<sup>23</sup> Van Hoof A, Raaijmakers QAW, van Beek Y, Hale III W, an Aleva L, "A multi - mediation model of the relations of bullying, victimization, identity and family with adolescent depressive symptoms," *Journal of Youth Adolescents*, 37( 2008): 772-782.

<sup>24</sup> Mynard H and Joseph,S, "Development of the multidimensional peer-victimization scale", *Aggressive Behavior*, 26 (2000): 169-178.

<sup>25</sup> Olweus, D, "Bully/victim problems in schools: Knowledge base and an effective intervention programme", *Irish Journal of Psychology*, 18 (1997): 170-190

<sup>26</sup> Rigby K and Slee P, "Bullying among Australian school children: reported behavior and attitudes toward victims", *Journal of School Psychology*, 131 (1992) : 615-627

<sup>27</sup> Estevez E, Jimenez TI, and Musitu G, "Violence and victimization at school in adolescence," in *School psychology: 21<sup>st</sup> century issues and challenges 2008*, ed. David H. Molina (Hauppauge, New York: Nova Science Publishers, 2008), 79-115.

<sup>28</sup> Russell PL, Nurius PS, Herting JR, Walsh E, and Thompson EA, "Violent victimization and Perpetration: Joint and Distinctive Implications for Adolescent Development," *Victim Offender* 5, no.4 (2010): 329-353.

sjelljes delikuyente.<sup>29</sup> Në përgjithësi, viktimizimi i të rinjve shfaqet me depresionin e moshës së re madhore, zemërimin, humbjen e shpresës, shkallën e lartë të pasigurisë, vetëvlerësimin e ulët dhe ankthin.<sup>30,31,32</sup> Ushtrimi i dhunës është i lidhur gjithashtu me shqetësimin emocional<sup>33</sup> dhe zemërimin.<sup>34</sup>

UNICEF-i ka njohur dhunën si problem të rëndë nëpër shkollat e Kosovës.<sup>35</sup> Të gjeturat tregojnë se fëmijët kanë përjetuar dhunën si prezencë të vazhdueshme në shkollat e tyre, kanë qenë dëshmitarë apo pjesëmarrës të formave të ndryshme të dhunës (verbale, fizike, emocionale, kërcënimeve apo abuzimit kriminal) në shkollë. Për më tepër, dënimet trupore ende perceptohen si metodë e pranueshme disiplinore në shkolla dhe në shtëpi, pranim ky që çon në arsyetim të dhunës nga mësimdhënësit, prindërit dhe fëmijët. Nuk ka studime të kryera me adoleshentët kosovarë mbi të kuptuarit e faktorëve të rrezikut që lidhen më ushtrimin e dhunës dhe viktimizimin. Duke marrë parasysh rezultatet nga studimet e lartpërmendura, ky studim synon të shqyrtojë ndërlidhjen në mes të disa faktorëve të rrezikut si:

---

<sup>29</sup> Bjornason T, Sigurdardottir TJ, and Thorlindson T, "Human agency, capable, guardians and structural constraints: A lifestyle approach of the study of violence victimization," *Journal of Youth and Adolescence* 28, no.2 (1999): 105-119.

<sup>30</sup> Brown GW, Craig TKJ, Harris TO, and Handley RV, "Parental maltreatment and adulthood cohabiting partnerships: A life-course study of adult chronic depression," *Journal of Affective Disorders* 110, no.1 (2008):115-125.

<sup>31</sup> Gladstone GL, Parker GB, and Malhi GS, "Do bullied children become anxious and depressed adults? A cross-sectional investigation of the correlates of bullying and anxious depression," *Journal of Nervous & Mental Disease* 194, no.3 (2006): 201-209.

<sup>32</sup> Bond L, Carlin JB, Thomas L, Rubin K, and Patton G, "Does bullying cause emotional problems? A prospective study of young teenagers," *British Medical Journal*, 323 (2001): 480-484.

<sup>33</sup> Peled M and Morreti MM, "Rumination on anger and sadness in adolescence: Fueling of fury and deepening despair," *Journal of Clinical Child and Adolescent Psychology* 36, 1(2007): 66-75.

<sup>34</sup> Blake CS and Hamrin V, "Current approaches to the assessment and management of anger and aggression: A review," *Journal of Child and Adolescent Psychiatric Nursing* 20, no.4 (2007): 209-221.

<sup>35</sup> UNICEF, *Research into violence against children in schools in Kosovo*, (Prishtina: UNICEF, Kosovo, 2005), 1-64

vetëvlerësimi, depresioni, përdorimi i alkoolit, arritjet akademike, ikja nga mësimi, me ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimin tek adoleshentët kosovarë. Ky është studimi i parë që shqyrton temën e ndërlidhjes së dhunës proaktive dhe viktimizimit dhe ato që lidhen me këto tek adoleshentët kosovarë.

### ***Metodat***

Analiza e këtij artikulli bazohet në të dhëna të mbledhura për studimin evropian në shkolla mbi alkoolin dhe drogat e tjera (ESPAD) 2011, që është kryer për herë të parë në Kosovë. Duke ndjekur kërkesat e studimit ESPAD, popullata e përzgjedhur në këtë mostër përbëhet nga nxënës të lindur në vitin 1995, pra të moshës 18 vjeçare në kohën e anketimit. Më tutje, kërkesat e studimit ESPAD për metodologjinë, përzgjedhjen e mostrës dhe administrimin, janë përshkruar në detaje nga Hibell, Guttormsson, Ahlström, Balakireva, Bjarnason, dhe Kokkevi (2009).<sup>36</sup> Para implementimit të studimit, është kërkuar leja nga grupi punues ndër-ministor dhe drejtoritë komunale për arsim. Nga 119 shkolla të mesme që operojnë në Kosovë, janë përzgjedhur 42 shkolla për studim. Për përzgjedhjen e shkollave është përdorur mostra e rastësishme e stratifikuar. Stratifikimi është bërë për një numër të caktuar shkollash të mesme private dhe publike dhe një numër klasash të përzgjedhura. Shkollat janë përzgjedhur nga lista e shkollave e marrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës. Studimi është kryer me 4,709 adoleshentë. Sa i përket gjinisë, 55.1% (N=2,597) ishin femra, 43.7% (N=2,057) ishin meshkuj dhe 1.2% (N=55) nuk janë përgjigjur në pyetjen për gjininë. Mesatarja e moshës për meshkuj ishte 15.65 (SD=.68) dhe për femra 15.63 (SD=.69).

Pyetësi i përdorur nga studimi i ESPAD, 2011 në Kosovë, ka përfshirë pyetje lidhur me alkoolin, drogat ilegale, duhanin dhe

---

<sup>36</sup> Hibell, B et al., *The 2009 ESPAD Report Substance Use Among Students in 35 European Countries*, European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction, (Stockholm: The Swedish Council for Information on Alcohol and Other Drugs, (2009): 29-58

aspektin psiko-social. Për qëllime të këtij artikulli janë përdorur njësitë që lidhen me modulin psiko-social, përfshirë ushtrimin e dhunës dhe viktimizimin, vetëvlerësimin, disponimin depresiv, përdorimin e alkoolit, arritjet akademike, ikjen nga mësimi dhe marrëdhënien me prindërit.

Variablat e varura të hulumtuara në këtë hulumtim ishin: ushtrimi i dhunës proaktive dhe viktimizimi.

Ushtrimi i dhunës proaktive është definuar duke kalkuluar shumën e pikëve për këto njësi; "Përgjatë 12 muajve të fundit, sa shpesh keni marrë pjesë": a) në ngacmim në grup, b) në mavijosje në grup, c) në një grup që fillon përlëshjen me një grup tjetër, d) duke filluar përlëshjen me një individ tjetër!. Pikët kanë variruar nga aspak, një apo dy herë, 3-5 herë, 6-9 herë, 10-19 herë, 20-39 herë dhe 40 e më shumë herë. Përgjigjet janë ri-koduar si: 0- aspak, 1- 9 herë, 2- 10-19 herë, 3- 2-39 herë dhe 4 - mbi 40 herë.

Viktimizimi është definuar duke kalkuluar shumën e pikëve për këto njësi; "Përgjatë 12 muajve të fundit, sa shpesh jeni": a) ngacmuar i vetëm nga një grup i tërë, b) mavijosur nga një grup i tërë, c) përlëshur në grupe me një grup që ka sulmuar, d) përlëshur individualisht me dikë që ka filluar përlëshjen i pari!. Përgjigjet e mundshme ishin: aspak, 1-2 herë, 3-5 herë, 6-9 herë, 10-19 herë, 20-39 herë dhe 40 a më shumë herë. Përgjigjet janë ri-koduar si: 0- aspak, 1-1-9 herë, 2- 10-19 herë, 3- 2-39 herë dhe 4 - mbi 40 herë.

Variablat e pavarura ishin këto: vetëvlerësimi i matur me shkallën e Rosenbergut për vetëvlerësim, duke vlerësuar ndjenjat e vlerës dhe pranimit të vetes.<sup>37</sup> Njësitë janë përgjigjur në shkallë 4-pikëshe nga "pajtohem fuqishëm" te "nuk pajtohem fuqishëm". Rezultatet u shtrinë nga 10 deri 40, ku pikët më të larta tregonin vetëvlerësim më të lartë. Disponimi depresiv është matur nga një version i shkurtuar me 6 njësi i Shkallës së Qendrës së Studimeve Epidemiologjike të Depresionit (CES-D), që nuk është i dizajnuar për depresion klinik por

---

<sup>37</sup> Rosenberg M. "Society and the adolescent self-image," accessed April 5, 2013, [http://www.education.uci.edu/childcare/pdf/instrumental\\_docs/Rosenberg%20Self-Esteem%20Scale%20ID.pdf](http://www.education.uci.edu/childcare/pdf/instrumental_docs/Rosenberg%20Self-Esteem%20Scale%20ID.pdf)



më shumë për vlerësim të nivelit të simptomave depressive.<sup>38</sup> Janë përdorur këto gjashtë njësi: gjatë 7 ditëve të fundit, sa shpesh: "ke humbur apetitin, nuk ke dashur të hash"; "ke pasur vështirësi të koncentrohesh në atë që ke dashur të bësh?"; "je ndjerë i deprimuar"; "je ndjerë se ke derdhur goxha mundim dhe shtytje në gjërat që duhet të bësh"; "je ndjerë i pikëlluar"; "nuk ke mundur të bësh punën tënde (në shkollë, në shtëpi, në punë)". Frekuenca është ndarë në shkallë 4-pikëshe, shtrirë nga "rrallë" deri te "shumicën e kohës". Arritja akademike është matur me pyetjen: "cila nga të mëposhtmet përshkruan më së miri notën mesatare të gjysmë vjetorit të fundit?" Përgjigjet janë koduar si: 1- tregon notat e ulëta mesatare, 2 - notat e mesme dhe 3- notat e larta. Përdorimi i alkoolit është matur me pyetjen: "Sa herë keni përdorur alkoolin në 30 ditët e fundit", dhe përgjigjet e mundshme ishin: fare, 1-2 herë, 3-5 herë, 6-9 herë, 10-19 herë, 20-39 herë dhe 40 a më shumë herë. Përgjigjet janë ri-koduar si: 0-fare dhe 1- një apo më shumë herë. Ikja nga mësimi është matur me pyetjen "Gjatë 30 ditëve të fundit, sa ditë keni munguar në një apo më shumë orë mësimi, pasi që keni ikur apo ndërprerë orën" Përgjigjet janë shtrirë nga aspak deri në 7 a më shumë ditë. Marrëdhënia me prindërit është matur duke kalkuluar shumën e pikëve për dy pyetje: "Sa je zakonisht i kënaqur në marrëdhënien me babain?" dhe "Sa je zakonisht i kënaqur në marrëdhënien me nënën?" Përgjigja shtrihej nga shumë i kënaqur tek aspak i kënaqur.

### **Rezultatet**

Para analizimit, është bërë një analizë eksploruese e të dhënave, për të parë se a ka qenë normale shpërndarja e pikëve mbi viktimizimin proaktiv, depresionin, viktimizimin dhe vetëvlerësimin. Rezultatet e testit Kolmogorov - Smirnov për normalitetin (Field, 2007) kanë shfaqur se shpërndarja e të katër rezultateve ka devijuar në mënyrë signifikante nga distribuimi normal, më detajuar: rezultatet e dhunës proaktive  $D = .496, p = .001$ , rezultatet e viktimizimit ( $D = .481, p =$

---

<sup>38</sup> Hibell, B et al., *The 2009 ESPAD Report Substance Use Among Students in 35 European Countries*. (2009): 173

.001), rezultatet e vetëvlerësimit ( $D = .108, p = .001$ ) dhe rezultatet e depresionit ( $D = .132, p = .001$ ).

Për analizë të mëtuqjeshme të variabëlve të interesimit tonë, kemi përdorur testin e Mann-Whitney U që vlerëson se a dallon mediana në variabël testi në mes grupesh të ndryshme. Testi i Mann Whitney U rezultoi me mesatare më të lartë të dhunës proaktive për meshkujt 2412.4 krahasuar me mesataren e femrave 2038.5 dhe dallimi ishte signifikant,  $z=-16.36, p<.001$ . Strukturë e ngjashme është gjetur edhe për viktimizimin, ku meshkujt patën mesatare më të lartë prej 2385.5 krahasuar me femrat 2057.6 dhe dallimi ishte signifikant,  $z=-13.3, p<.001$ . Femrat kanë raportuar mesatare më të lartë depresioni 2285.9 krahasuar me meshkujt 1689.8,  $z=-16.2, p<.001$ .

Korrelacioni i koeficientit të Spearman-it rezultoi në korrelacion negativ të sjelljes së dhunshme proaktive  $\rho=-.08, p<.001$  dhe viktimizimit  $\rho=-.06, p<.001$  me rezultatet e vetëvlerësimit. Korrelacion pozitiv është gjetur për rezultatet e sjelljes së dhunshme proaktive  $\rho=.12, p<.001$  dhe viktimizimit  $\rho=.15, p<.001$  me depresionin.

Rezultatet mesatare të viktimizimit dhe dhunës proaktive janë analizuar duke krijuar dy grupe artificiale të studentëve me rezultate mesatare nga 1 në 3 dhe një grup me nga 4 deri 5.<sup>39</sup> Të gjeturat tregojnë se nxënësit me nota më të ulëta kanë shfaqur mesatare më të lartë të dhunës proaktive 2225.2 krahasuar me nxënësit me mesatare më të lartë të notave 2113.4,  $z=-4.76, p<.001$ . Të gjetura të ngjashme janë vërejtur edhe për rezultatet mesatare të viktimizimit, ku nxënësit me mesatare më të ulët kanë raportuar shkallë më të lartë mesatare të viktimizimit 2216.2 krahasuar me ata që kanë mesatare më të lartë të notave 2113.4,  $z=-4.04, p<.001$ . Krahasimi i mesatareve me One Way ANOVA të mesatares së dhunës proaktive kanë rezultuar me dallime signifikante mesataresh, në mes nxënësve që nuk kanë përdorur

---

<sup>39</sup> Salmivalli C, Kaukiainen A, Kaistaniemi L, and Lagerspetz KM, "Self-evaluated self-esteem, peer evaluated self-esteem and defensive egotism as predictors of bullying situations," *Personality Sociological Psychological Bulletin*, 25 (1999): 1268-1278.

alkool në 30 ditët e fundit, krahasuar me ata që kanë përdorur alkool në 30 ditët e fundit ( $F(6, 4172) = 68.22, p < 0.001$ ). Sa i përket rezultateve mesatare të dhunës proaktive për numrin e raportuar të pijeve në 30 ditët e fundit, adoleshentët që kanë raportuar përdorim të alkoolit kanë raportuar mesatare më të larta të dhunës proaktive krahasuar me adoleshentët që nuk kanë përdorur alkool fare. Strukturë e ngjashme është gjetur për rezultatet e viktimizimit, ku adoleshentët që nuk kanë raportuar përdorim të alkoolit në 30 ditët e fundit kanë raportuar mesatare më të ulëta me dallim signifikant ndaj adoleshentëve që kanë raportuar përdorim të alkoolit në 30 ditët e fundit ( $F(6, 4159) = 66.73, p < 0.001$ ).

Tabela 1 paraqet të gjeturat nga regresioni logjistik binar për ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimin. Kjo tregon se disa faktorë duket se ndërlidhen me ushtrimin e dhunës proaktive në mesin e adoleshentëve kosovarë. Më specifikisht, ikja nga mësimi, konsumimi i alkoolit në 30 ditët e fundit, disponimi depresiv, marrëdhënia me prindërit dhe të qenit femër kanë qenë statistikiisht signifikante në shkallë ( $p < 0.01$ ) dhe mesatarja e notave statistikiisht signifikante në shkallë ( $p < 0.05$ ) për adoleshentët që kanë ushtruar dhunë proaktive krahasuar me ata që nuk kanë ushtruar (kategori referente). Vetëm rezultatet e vetëvlerësimit nuk kanë treguar raport statistikiisht signifikant me ushtrimin e dhunës proaktive. Më tutje, rezultatet nga tabela 1 shënojnë se ndërlidhja më e fuqishme e ushtrimit të dhunës proaktive ishte me ikjen nga mësimi (OR=2.78, 95% CI: 2.01-3.83), përcjellë nga konsumi i alkoolit për 30 ditë (OR=2.78, 95% CI: 2.01-3.83), mesataren e notave (OR=1.36, 95% CI: 1.04-1.78) dhe disponimi depresiv (OR=1.12, 95% CI: 1.08-1.15), përderisa ndërlidhja me marrëdhënien me prindërit (OR=0.78, 95% CI: 0.69-0.87) dhe gjininë ishin relativisht të dobëta (OR=0.17, 95% CI: 0.12-0.22).

Tabela 1. Regresioni logjistik binar multivariabël për ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimin

	Dhuna proaktive OR (95%)	VLERA - P	Viktimizimi OR (95%)	VLERA - P
<b>Gjinia</b>				
Mashkull	R		R	
Femër	0.171 (0.12-0.228)	0.001**	0.29 (0.23-0.38)	0.001**
<b>Nota mesatare</b>				
Notat e ulëta	R		R	
Notat e larta	1.36 (1.04-1.78)	0.022*	1.24 (0.97-1.59)	0.083
<b>Ikja nga mësimi</b>				
Jo	R		R	
Po	2.78 (2.01-3.83)	0.001**	1.87 (1.37 - 2.57)	0.001**
Vetëvlerësimi	2.21 (1.62-3.00)	0.283	1.00 (1.08- 1.15)	0.916
Disponimi depresiv	1.12 (1.08-1.15)	0.001**	1.18 (1.08-1.15)	0.001**
<b>Konsumimi i alkoolit</b>				
Jo	R		R	
Po	2.21 (1.62-3.00)	0.001**	2.96 (2.23- 3.94)	0.001**
Marrëdhënia me prindërit	0.78 (0.69-0.87)	0.001**	0.81 (0.73 - 0.90)	0.01**

Në mënyrë të ngjashme, të gjeturat nga tabela 1 tregojnë se shumë faktorë kanë dalë të jenë të ndërlidhur me përvojën e viktimizimit tek adoleshentët kosovarë. Më në detaje, ikja nga mësimi, konsumimi i alkoolit në 30 ditët e fundit, disponimi depresiv, marrëdhënia me prindërit dhe të qenit femër, të gjitha ishin statistikisht signifikante në shkallë ( $p < 0.01$ ) për adoleshentët që kanë përjetuar viktimizim krahasuar me ata që nuk kanë përjetuar (kategori referente). Megjithatë, nota mesatare dhe vetëvlerësimi nuk ishin statistikisht signifikante.

Lidhja më e ngushtë është vërejtur në mes të konsumimit të alkoolit në 30 ditët e fundit (OR=2.96, 95%, CI: 2.23-3.94), përcjellë nga ikja nga mësimi (OR=1.87, 95% CI: 1.37-2.57) dhe disponimi depresiv (OR= 1.11, 95% CI: 1.08-1.15). Ndërlidhja më e dobët është vërejtur me marrëdhënien me prindërit (OR= 0.81, 95% CI: 0.73-0.90) dhe gjininë (OR= 0.29, 95% CI: 0.23-0.38).

Për më tepër, lëvrimi i rezultateve nga tabela 1 na zbulon se të qenit femër ul gjasat për ushtrimin e dhunës proaktive për 0.1 herë dhe për përjetim të viktimizimit për 0.3 herë krahasuar me meshkujt. Më tej, adoleshentët me notë mesatare më të lartë kanë më shumë gjasa për ushtrimin e dhunës proaktive për 1.3 herë krahasuar me adoleshentët me notë mesatare më të ulët, por kjo nuk ishte konsistente për viktimizimin. Adoleshentët që kanë konsumuar alkool në 30 ditët e fundit kanë më shumë gjasa për ushtrimin e dhunës proaktive për 2.21 herë krahasuar me ata që nuk kanë konsumuar alkool. Ngjashëm, adoleshentët që kanë përdorur alkool në 30 ditët e fundit kanë pothuajse 3 herë më shumë gjasa për të qenë viktimë të dhunës krahasuar me ata që nuk kanë konsumuar alkool. Adoleshentët që kanë marrëdhënie të kënaqshme me prindërit kanë më pak gjasa për ushtrimin e dhunës proaktive për 0.71 herë dhe gjasa më të vogla për viktimizim për 0.81 herë. Rritja e një njësie në shkallën e disponimit depresiv rrit gjasat për ushtrimin e dhunës proaktive për 1.10 herë dhe 1.18 herë për viktimizim.

## ***Diskutim***

Viktimizimi nga dhuna dhe ushtrimi i saj janë identifikuar si faktorë të rëndë rreziku për zhvillimin e mangët tek adoleshentët.<sup>40</sup> Ky studim ka hulumtuar ndërlidhjen në mes të disa faktorëve të rrezikut si: vetëvlerësimi, depresioni, përdorimi i alkoolit, arritjet akademike, ikja nga mësimi me ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimin tek adoleshentët kosovarë. Analiza e këtij punimi është bazuar në mbledhjen e të dhënave nga Projekti Evropian për anketimin e

---

<sup>40</sup> Barnow S, Lucht M, and Freyberger HJ, "Correlates of aggressive and delinquent conduct problems in adolescence," *Aggressive Behavior* 31, no.1 (2005):24-39.

shkollave mbi alkoolin dhe drogat e tjera (PEShAD) 2011, që është kryer për herë të parë në Kosovë.<sup>41</sup>

Rezultatet nga ky studim mbështesin të gjeturat nga studimet e tjera<sup>42</sup> se meshkujt kanë pasur mesatare më të lartë si në dhunën proaktive ashtu dhe në viktimizim kur krahasohen me femrat dhe dallimi është signifikant ( $p < 0.001$ ). Më tutje, regresioni logjistik binar multivariabël ka shfaqur se faktorët që përputhen duket se ndërlidhen me ushtrimin e dhunës proaktive dhe viktimizimin tek adoleshentët kosovarë. Ndërlidhja më e fortë ishte në mes të dhunës proaktive dhe viktimizimit me konsumimin e alkoolit brenda 30 ditësh, përcjellë me ikje nga mësimi dhe disponimi depresiv. Ndërlidhja më e ulët është vërejtur me marrëdhënien me prindërit dhe gjininë. Megjithatë, rezultatet e vetëvlerësimit tregojnë se nuk ka pasur dallime statistike signifikante në mes dhunës proaktive dhe viktimizimit. Gjithë të lartpërmendurat theksojnë përputhjen e dhunës proaktive me viktimizimin në mesin e adoleshentëve,<sup>43</sup> duke nënvizuar rolin e tyre si ushtrues dhune dhe viktimë.<sup>44</sup>

Duke nënkuptuar se shkollat, personeli dhe psikologu tani janë në situatë më sfiduese për shkak të faktorëve ndërlidhës rreth kësaj çështjeje, sidomos pasi që normat sociale mbështetëse për dhunën merren nga adoleshentët si reagime nga jashtë.<sup>45</sup> Megjithatë, adresimi i viktimave të dhunës para pjesëmarrjes së tyre në agresion të

---

<sup>41</sup> Hibell, B et al., The 2009 ESPAD Report Substance Use Among Students in 35 European Countries, (2009):172-180

<sup>42</sup> Cairns RB, Cairns BD, Neckerman HJ, Ferguson LL, and Garipey JL, "Growth and aggression: 1. Childhood to early adolescence," *Developmental Psychology* 25, no.2 (1989):320-330.

<sup>43</sup> Pellegrini AD, Bartini M, Brooks F, "School bullies, victims, and aggressive victims: Factors relating to group affiliation and victimization in early adolescence," *J Educ Psychol* 91, no.2 (1999):216-224.

<sup>44</sup> Singer S, "Victims of serious violence and their criminal behavior: Subcultural theory and beyond", *Victims Violence* 1, no.1 (1986):61-70.

<sup>45</sup> UNICEF, *Research into violence against children in schools in Kosovo*, (Pristina: UNICEF, Kosovo, 2005), 1-64.

dhunshëm, paraqet shanse për ta thyer ciklin e dhunës si viktimë dhe ushtrues dhune.<sup>46</sup>

## **Bibliografia**

Barnow S, Lucht M, and Freyberger HJ, "Correlates of aggressive and delinquent conduct problems in adolescence," *Aggressive Behavior* 31, no.1 (2005):24–39.

Bjornason T, Sigurdardottir TJ, and Thorlindson T, "Human agency, capable, guardians and structural constraints: A lifestyle approach of the study of violence victimization," *Journal of Youth and Adolescence* 28, no.2 (1999): 105-119.

Blake CS and Hamrin V, "Current approaches to the assessment and management of anger and aggression: A review," *Journal of Child and Adolescent Psychiatric Nursing* 20, no.4 (2007): 209–221.

Bond L, Carlin JB, Thomas L, Rubin K, and Patton G, "Does bullying cause emotional problems? A prospective study of young teenagers," *British Medical Journal*, 323 (2001): 480-484.

Brengden M, Vitaro F, Tremblay RE and Lavoie F, "Reactive and pro-active aggression: Predictions to physical violence in different contexts and moderating effects of parental monitoring and caregiving behaviors," *Journal of Abnormal Child Psychology* 29, no.4 (2001): 293-304.

Brown GW, Craig TKJ, Harris TO, and Handley RV, "Parental maltreatment and adulthood cohabiting partnerships: A life-course study of adult chronic depression," *Journal of Affective Disorders* 110, no.1 (2008):115–125.

Cairns RB, Cairns BD, Neckerman HJ, Ferguson LL, and Gariepy JL, "Growth and aggression: Childhood to early adolescence," *Developmental Psychology* 25, no.2 (1989):320–330.

---

<sup>46</sup> Mario J. Aceves, and Jeffrey T. Cookston, "Violent Victimization, Aggression, and Parent-Adolescent Relations: Quality Parenting as a Buffer for Violently Victimized Youth," *J Youth Adolescence*, 36(2007): 635–647.

Cameron JL, "Interrelationships between hormones, behaviors, and affect during adolescence," *Annals of the New York Academy of Sciences*, 1021 (2004): 134-42.

Dahl RE, "Adolescent brain development: A period of vulnerabilities and opportunities," *Annals of New York Academia of Science*, 102 (2004): 1-22.

Dawkins MP, "Drug use and violent crime among adolescents," *Adolescence*, 33(1997): 395-405.

Desai, S, Arias, I, Thompson, MP, and Basile, KC, "Childhood victimization and subsequent adult re-victimization assessed in a nationally representative sample of women and men," *Violence and victims* 17, no.6 (2002): 639-653.

Dodge KA, "The structure and function of reactive and proactive aggression," in *The Development and Treatment for Childhood Aggression 1991*, Pepler D and Rubin K (Hillsdale: Erlbaum, 1991), 201-218.

Estevez E, Jimenez TI, and Musitu G, "Violence and victimization at school in adolescence," in *School psychology: 21<sup>st</sup> century issues and challenges 2008*, ed. David H. Molina (Hauppauge, New York: Nova Science Publishers, 2008), 79-115.

Fang X and Corso PS, "Child maltreatment, youth violence and intimate partner violence: Developmental relationship," *American Journal of Preventive Medicine* 33, no.4 (2007): 281-290.

Gladstone GL, Parker GB, and Malhi GS, "Do bullied children become anxious and depressed adults? A cross-sectional investigation of the correlates of bullying and anxious depression," *Journal of Nervous & Mental Disease* 194, no.3 (2006): 201-209.

Graham RA et. al., "The existential model of perfectionism and depressive symptoms: a short four wave longitudinal study," *Journal of Consulting Psychology*, 57 (2011): 23-438.

Hibell B, Guttormsson U, Ahlström S, Balakireva O, Bjarnason T, Kokkevi, A., et al. *The 2009 ESPAD Report Substance Use Among Students in 35 European Countries*. 2009 . European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA) . Stockholm: The Swedish Council for Information on Alcohol and Other Drugs (CAN).

Hubbard JA, Romani LJ, McAuliffe MD and Morrow MT, "Reactive and proactive aggression in childhood and adolescence:



Precursors, outcomes, processes, experiences and measurement," *Journal of Personality* 78, no.1 (2010):96-118.

Maas C, Herrenkohl T, and Sousa C, "Review of research on child maltreatment and violence in youth," *Trauma, Violence & Abuse*, 9(2008): 56-67.

Mario J. Aceves, and Jeffrey T. Cookston, "Violent Victimization, Aggression, and Parent-Adolescent Relations: Quality Parenting as a Buffer for Violently Victimized Youth," *J Youth Adolescence*, 36(2007): 635-647

Mynard H and Joseph,S, "Development of the multidimensional peer-victimization scale", *Aggressive Behavior*, 26 (2000): 169-178.

Office of the Surgeon General (US); National Center for Injury Prevention and Control (US); National Institute of Mental Health (US); Center for Mental Health Services (US). Youth Violence: A Report of the Surgeon General. Rockville (MD): Office of the Surgeon General (US); 2001. Chapter 4 -- [http://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK44293/Risk Factors for Youth Violence](http://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK44293/Risk_Factors_for_Youth_Violence).

Olweus, D, "Bully/victim problems in schools: Knowledge base and an effective intervention programme", *Irish Journal of Psychology*, 18 (1997): 170-190.

Peled M and Morreti MM, "Rumination on anger and sadness in adolescence: Fueling of fury and deepening despair," *Journal of Clinical Child and Adolescent Psychology* 36, 1(2007): 66-75.

Pellegrini AD, Bartini M, Brooks F, "School bullies, victims, and aggressive victims: Factors relating to group affiliation and victimization in early adolescence," *J Educ Psychol* 91, no.2 (1999):216-224.

Price KF and Dodge KA, "Reactive and proactive aggression in childhood: relations to peer status and social context dimensions," *Journal of Abnormal Child Psychology*, 17(1989): 455-471.

Rigby K and Slee P, "Bullying among Australian school children: reported behavior and attitudes toward victims", *Journal of School Psychology*, 131 (1992) : 615-627

Rosenberg M, "Society and the adolescent self-image," accessed April 5, 2013, [http://www.education.uci.edu/childcare/pdf/instrumental\\_docs/Rosenberg%20Self-Esteem%20Scale%20ID.pdf](http://www.education.uci.edu/childcare/pdf/instrumental_docs/Rosenberg%20Self-Esteem%20Scale%20ID.pdf)

Russell PL, Nurius PS, Herting JR, Walsh E, and Thompson EA, "Violent victimization and Perpetration: Joint and Distinctive Implications for Adolescent Development," *Victim Offender* 5, no.4 (2010): 329-353.

Salmivalli C, Kaukiainen A, Kaistaniemi L, and Lagerspetz KM, "Self-evaluated self-esteem, peer evaluated self-esteem and defensive egotism as predictors of bullying situations," *Personality Sociological Psychological Bulletin*, 25 (1999): 1268-1278.

Saner H and Ellickon P, "Concurrent risk factors for adolescent violence," *Journal of Adolescence Health*, 19(1996): 94-103.

Singer S, "Victims of serious violence and their criminal behavior: Subcultural theory and beyond", *Victims Violence* 1, no.1 (1986):61-70.

UNICEF, *Research into violence against children in schools in Kosovo*, (Pristina: UNICEF, Kosovo, 2005), 1-64.

Van Hoof A, Raaijmakers QAW, van Beek Y, Hale III W, and Aleva L, "A multi - mediation model of the relations of bullying, victimization, identity and family with adolescent depressive symptoms," *Journal of Youth Adolescents*, 37( 2008): 772-782.

World Health Organization, *Mental health: facing the challenges, building solutions: Report from the WHO European Ministerial Conference*, (Copenhagen: Regional Office for Europe, 2005),